



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-076

Prishtinë, më 17 nëntor 2016, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri dhe Pal Lekaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit

Kryetari njoftoi të pranishmit se Grupi prej 40 deputetëve ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, me këtë rend dite:

1. Debat lidhur me zhvillimet e fundit hetimore me rastin e vdekjes së të paraburgosurit Astrit Dehari në Qendrën e Paraburgimit në Prizren

Në ndërkohë, dy deputetët e Kuvendit, Veton Berisha dhe Danush Ademi, i kanë tërhequr nënshkrimet nga kërkesa e parashtruar.

Kryetari, me pëlqimin e nënkryetarëve të Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm në mbledhje konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 9:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale